

Tomazh Petek është një specialist në sektorin publik me përvojë të gjerë në fushën e sistemit gjeodezik, gjeoinformatik, kadastrit të tokës, të dhënat për infrastrukturën hapësinore dhe reformën e qeverisjes; punën rregullatore për projektet gjeodezike e shtetërore dhe projektet e infrastrukturës së të dhënave hapësinore; zhvillimin e infrastrukturës gjeoinformatike në Republikën e Sllovenisë dhe menaxhimin e autoriteteve rajonale gjeodezike.

Vepron si zëvendës drejtor i përgjithshëm i Departamentit të Gjeodezisë dhe hartografisë së Republikës së Sllovenisë në periudhën prej vitit 2014 - 2015, si dhe anëtar i Komitetit Ekzekutiv të Evropës GGIM të OKB-së që nga viti 2014. Gjatë karrierës profesionale punon në disa poste që kanë të bëjnë me sistemet topografike dhe hartografike në Republikën e Sllovenisë, si dhe drejtor i drejtorisë kadastrorë rajonale në Lubjanë. Ai është i përfshirë në shumë aktivitete të EuroGeographics dhe GGIM të OKB-së për Europën, si dhe anëtar i Komitetit Ekzekutiv dhe është i angazhuar në disa projekte kombëtare dhe ndërkombëtare që kanë të bëjnë me regjistrimin e tokës dhe menaxhimin e të dhënave hapësinore. Si një ekspert, ai merr pjesë aktive në implementimin dhe në zbatimin e projekteve të rëndësishme të BE-së në fushën gjeoinformatike të INSPIRE në nivel kombëtar . Përveç kësaj, ai vepron si një pikë kontakti kombëtar për koordinimin dhe zbatimin e implementimit të INSPIRE me Komisionin Evropian.

Merr pjesë si një udhëheqës i nën-projektit në Projektin mjedisi jetesor i Bankës Botërore, - komponent Onix sistem i informacionit gjeografik (SIG), e cila është themeluar si një Qendër e Informacionit Gjeografik , si dhe ngritjen e vetëdijes në treg për shkëmbimin e informacionit dhe ofrimin e ndihmës për administratën rajonale , agjencitë qeveritare dhe departamentet, përdoruesit vendas dhe të huaj,shërbimet industriale , komerciale . Është pëfshirë në përgatitjen e Projektit për regjistrimin e pasurive të patundshme në Slloveni për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e menaxhimit të pasurive të patundshme.

Është aktiv si:

- Përfaqësues slloven në Komitetin e përhershëm të INSPIRE-it;
- Kryetari i komisionit shtetëror mes kufirit shtetëror me Italinë, Austrinë dhe Hungarinë;
- Anëtar i Shoqatës sllovene të Surveyors që nga viti 1993 dhe anëtar i Bordit Ekzekutiv të shoqatës që nga viti 2002;
- Anëtar i Komitetit të përhershëm Evropian INSPIRE nga viti 2007;
- Anëtar i Bordit drejtues të EuroGeographics që nga viti 2011-2014; dhe
- Anëtar i Këshillit drejtues të KB GGIM Europe nga viti 2014.